



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Njoftim për mediat

Seanca dëgjimore me shoqërinë ARMO për raportin e hetimit të thelluar “Mbi sjelljen e ndërmarrjes “ARMO” sha. në tregun e produktit lëndë djegëse Diesel D2”.

Tiranë, 2 qershor 2010 - Në përfundim të raportit të hetimit të thelluar “Mbi sjelljen e ndërmarrjes “ARMO” sha. në tregun e produktit lëndë djegëse Diesel D2” dhe në zbatim të procedurave që parashikon ligji nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sot në ambientet e Autoritetit të Konkurrencës u zhvillua një seancë dëgjimore me shoqërinë ARMO, si palë nën hetim.

Përfaqësuesit e shoqërisë ARMO paraqiten argumentet e tyre në lidhje me raportin e përgatitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës.

Pikat kryesore të diskutimeve u përqendruan në situatën e kësaj ndërmarrjeje në periudhën pas privatizimit dhe detyrimet ligjore që ka kjo ndërmarrje në bazë të ligjeve të ndryshëm të cilët kanë përcaktuar sjelljen e saj.

Me përfundimin e seancës dëgjimore dhe vënien në dispozicion të të gjithë informacionit të nevojshëm, Komisioni i Konkurrencës do të marrë një vendim përfundimtar mbi këtë hetim.

